



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:103246  
Datë: 19.11.2024  
Numri i dokumentit: 06471770

E.Rev.nr.55/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Nenad Llaziq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NP .... "I...." sh.a me seli në F. K., kundër te paditurës A.T."M.T." me pronar R. E. nga fshati Zh., Komuna e P., të cilën me autorizim e përfaqëson av. Fatbardha Elezkurtaç nga P., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 10757/2023, të datë 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hedhet poshtë si i palejuar revizioni i të paditurës A.T."M.T." me pronar R. E. nga fshati Zh., Komuna e P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 10757/2023, të datë 21.02.2024.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.218/2019, datë 22.10.2019 ishte vendosur që "I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit NP .... "I...." sh.a. F. K. dhe detyrohet i padituri A.T."M. T." nga fshati Zh., Komuna e P., që paditësit t'ia paguajë borxhin në emër të qirasë në shumën prej 4,562.42 euro, si dhe t'ia lirojë dhe dorëzojë në posedim paditësit pronën e marrë me qira pjesën prej 300 m2 të ngastrës kadastrale ....., ZK P., të gjitha në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit NP .... "I...." sh.a. F. K. mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar prej 7,694.42 euro, refuzohet si e pa bazuar. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale."

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 10757/2023, të datës 21.02.2024, ishte vendosur "Refuzohen si te pa themelta ankesat e palëve ndërgjyqese, e paditësit NP .... "I...." sh.a me seli në F. K. dhe të paditurës, A.T."M. T." me pronar R. E. nga fshati Zh., Komuna e P., ashtu që vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.218/19 i datës 22.10.2019.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr. 10757/2023, të datës 21.02.2024, në afat ligjor, e paditura, përmes të autorizuarës av. Fatbardha Elezkurtaç nga P. ka paraqitur revizion e paditura A.T."M. T.", me pronar R. E. nga fshati Zh., për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta pranojë si të bazuar revizionin, të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje, gjykatës së shkallës së parë.

Paditësi NP .... "I...." sh.a me seli në F. K., nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, dhe nenit 14.2 e Ligji nr. 08/1-015 Për Gjykatën Komerciale, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është palejueshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi. NP .... "I..." sh.a me seli në F. K., pranë Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur padi për përmbushjen e detyrimit ne emër te borxhit nga qiraja në shumë prej 7,694.42€, ndërsa e paditura, në përgjigje në padi ka kundërshtuar ne tersi pretendimet e palës paditëse, si te pa bazuara.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht në shumën prej 4,562.42 €, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë prej 3,132.00 €, e ka refuzuar, si të pa bazuar. Ndaj këtij aktgjykimi kishin paraqitur ankesë të dy palët por gjykata e shkallës së dytë i kishte refuzuar ankesat dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ka paraqitur revizion e paditura, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike kontestimore fillimisht vlerëson e lejueshmërinë e revizionit dhe gjen se në rastin konkret revizioni është i palejueshëm.

Pala paditëse, kishte kërkuar pagesën e borxhit në shamë prej 7,694.42, gjykata e shkallës së parë e kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën prej 4,562.42 €, ndërsa pjesën prej 3,132.00 €, e ka refuzuar.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se me dispozitat e nenit 508 të LPK, përcaktohet se: *“Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 €”*.

Në rastin konkret, me qenë se aktgjykimi i shkallës së dytë ishte nxjerr nga Gjykata Komerciale e Kosovës, duhej aplikuar dispozitën e nenit 14.1 e Ligji nr. 08/1-015 Për Gjykatën Komerciale përshihet se "Lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës zbatohen ligjet procedurale në fuqi". Ndërsa paragrafi 2 parasheh se "Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 30.000 (tridhjetëmijë Euro)€. Prandaj në kontestin, si në rastin konkret vlera e kontestit është nën limitet e përcaktuara me ligj.

Më qenë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh revizionin e të paditurës ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 218 të LK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës sipas dispozitës së nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Sipas arsyeve të sipër theksuara më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

E.Rev.nr.55/2024, datë 19.11.2024

Kryetar i kolegjit,

Beshir Islami